

U D H Ë Z I M
Nr. 43, datë 3.6.2001

**PËR DISA KRITERE TË PARAQITJES SË KANDIDATËVE PËR DEPUTET DHE
PËRLLOGARITJEN E NDARJES SË MANDATEVE PLOTËSUESE**

Në mbështetje të neneve 68 dhe 153 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 2 pika 4, 18, 66, 76, 77 dhe 78 të ligjit nr. 8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N :

Për zbatimin e ligjit, gjatë procesit parazgjedhor dhe zgjedhor dhe për njësimin e praktikave zgjedhore, lidhur me kriteret e paraqitjes së kandidatëve të pavarur dhe përllogaritjen e ndarjes së mandateve plotësuese, të vepohet si vijon :

1. Në kuptim të nenit 2 pika 4 të Kodit Zgjedhor, me “kandidat i pavarur” do të kuptohet ai kandidat për deputet në zonën njëemërore që nuk mbështetet nga asnjë parti politike ose koalicion partish, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi.

2. Me “mbështetje” të kandidatit të pavarur do të kuptohet mbështetja e drejtpërdrejtë ose tërthorazi e fushatës zgjedhore e kandidatit të pavarur me mjete financiare dhe materiale, që disponohen nga parti politike, grupim a koalicione partish.

3. Kur kandidati që konkurron si i pavarur është kryetar apo anëtar i kryesisë së partisë në një zonë zgjedhore deri më datë 24.5.2001, atëherë ky kandidat, për efekt të llogaritjes së shkronjës “B” të nenit 66 të Kodit Zgjedhor, do të konsiderohet si kandidat i partisë të cilën ai drejton.

4. Nëse gjatë fushatës zgjedhore, partitë politike ose koalicionet e partive kanë bashkëpunuar me më shumë se 20 kandidatë të pavarur, atëherë, për efekt të llogaritjes së shkronjës “B” të nenit 66 të Kodit Zgjedhor, çdo kandidat i pavarur mbi këtë numër do të konsiderohet si kandidat i partisë me të cilën ka bashkëpunuar.

5. Menjëherë pas marrjes dijeni nga KZZ-të ose subjekte zgjedhore të të dhënave a informacioneve që përbëjnë bazë të mjaftueshme për verifikimin e njërit prej rasteve të parashikuara në pikën 1 mësipër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i kërkon kandidatit të pavarur dhe subjektit politik përkatës të deklarojë me shkrim përpara KQZ-së nëse mbështet ose jo kandidatin e pavarur.

6. Në rastin e deklarimit me shkrim të subjektit politik për mbështetjen e kandidatit të pavarur, heshtjes a refuzimit të bërjes së këtij deklarimi përpara KQZ-së, kjo e fundit fillon menjëherë procedurat për përllogaritjen e kandidatit të pavarur në favor të partisë politike, grupimit a koalicionit partiak mbështetës të tij, në kuptim të nenit 66 pika 1 shkronja b të Kodit Zgjedhor.

7. Kur disa parti konkurojnë për ndarjen e mandateve plotësuese në proporcional si koalicion, kurse në zonat njëemërore konkurojnë si parti më vete, për efekt të zbatimit të nenit 64 pika 2 të Kushtetutës dhe të nenit 66 të Kodit Zgjedhor, deputetët që këto parti kanë fituar në zonat njëemërore do të llogariten si deputetë të fituar në këto zona nga koalicioni i partive.

Kandidatët që konkurrojnë në zonat njëemërore dhe që mbështeten nga dy ose më shumë parti politike, do të konsiderohen si kandidatë të mbështetur nga koalicioni i partive.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirian Celibashi